



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
Prokuroria Themelore Ferizaj / Osnovno Tužilaštvo Ferizaj / Ferizaj Basic Prosecution

AD.nr.2/24

Dt: 06 Shtator 2024

Ferizaj

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, duke vendosur lidhur me ankesën-kërkesë për inicim të procedurës disiplinore, të paraqitur nga mbrojtësi i ankuesit [REDACTED] avokati [REDACTED] ndaj prokurorit të Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Ferizaj [REDACTED] në bazë të nenit 9 paragrafi 1, pika 1.5 dhe paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L - 057, për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datë 06.09.2024, merr:

V E N D I M

HUDHET, ankesa-kërkesa për inicim të procedurës disiplinore, të paraqitur nga mbrojtësi i palës ankuese [REDACTED] avokat [REDACTED] ndaj Prokurorit të Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Ferizaj [REDACTED] ngase pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, me asnjë provë nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer shkelje disiplinore, nga neni 6 paragrafi 1 nënpar.1.3 dhe paragrafi 2 nënpar.2.2 të Ligjit Nr. 06/L-057, për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me datë 21.08.2024, nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka pranuar rastin e evidentuar AD.nr.06/2024, të dt.14.08.24, në kompetencë, e paraqitur nga Avokat [REDACTED] i cili e përfaqëson ankuesin [REDACTED] ndaj Prokurorit të Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Ferizaj [REDACTED]

Ankuesi, pretendon se prokurori [REDACTED] ka kryer shkelje disiplinore gjatë trajtimit të çështjes penale [REDACTED] dhe atë sipas ankuesit edhe pse në shkresat e lëndës ka pasur prova të mjaftueshme se i dyshuari në këtë çështje penale ka kryer veprat penale Vetëgjyqësia nga neni 410 të KPRK-së si dhe veprën Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

Tutje ankuesi, pretendon se prokurori në fjalë ka paraqitur fakte të rreme për të marrë aktvendim për pushim të hetimeve, po ashtu pretendon se prokurori nuk i ka kryer detyrat si prokuror i shtetit sipas ligjeve të aplikueshme duke aplikuar fakte të rreme në arsyetimin e aktvendimit.

Pas pranimit dhe analizimit të ankesës-kërkesës për inicim të procedurës disiplinore, të paraqitur nga ana e ankuesit, konsiderojmë se pretendimet e palës ankuese nuk qëndrojnë për faktin se:

Bazuar në shkresat e lëndës [REDAKTUAR], prokurori në fjalë brenda afateve ligjore ka ndërmarrë të gjitha veprimet hetimore, ashtu që fillimisht më dt. 17.05.2024, ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve, pastaj gjatë fazës së hetimeve ka intervistuar në cilësinë e dëmtuarit tani ankuesin [REDAKTUAR] si dhe të pandehurin [REDAKTUAR] me ç' rast pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe fakteve lidhur me këtë çështje penale, prokurori i shtetit më dt.12.06.2024, ka marrë Aktvendim për Pushimin e Hetimeve sepse me asnjë provë nuk është vërtetuar dyshimi i arsyeshëm se janë kryer veprat penale lartëcekura, me ç' rast pala e dëmtuar është njoftuar me aktvendim se ka të drejtë ankese kundër këtij aktvendimi për pushimin e hetimeve në Prokurorinë e Apelit, përmes prokurorisë e cila ka marrë këtë aktvendim.

Pala e dëmtuar më dt.10.07.2024, ka paraqitur ankesë kundër aktvendimit [REDAKTUAR], në Prokurorinë e Apelit me propozim që e njëjta ankesë të aprovohet si bazuar dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Nga Prokuroria e Apelit kemi pranuar Aktvendimin [REDAKTUAR] të dt.18.07.2024, me të cilën është aprovuar ankesa e palës se dëmtuar dhe është anuluar aktvendimi mbi pushimin e hetimeve me numër dhe datë të lartëcekur, ashtu që lënda është kthyer në këtë prokurori për shqyrtim të serishëm si dhe ndërmarrjen e veprimeve hetimore shtesë.

Prokurori me të pranuar këtë aktvendim, duke vepruar sipas udhëzimeve të Prokurorisë së Apelit, menjëherë ka filluar ndërmarrjen e veprimeve shtesë ashtu që pas ndërmarrjes së të gjitha veprimeve sipas rekomandimeve të prokurorisë së apelit do të vendoset për rastin.

Nga të lartcekurat dhe pas vlerësimit të kërkesës dhe shkresave tjera të lëndës kemi konstatuar se në rastin konkret, prokurori ka ndërmarrë të gjitha veprimet hetimore dhe konform dispozitave ligjore ka vendosur për çështjen.

Andaj, pas vlerësimit të kërkesës për inicim të procedurës disiplinore së lartcekur, është konstatuar se në rastin konkret nuk ekziston asnjë shkelje disiplinore, e paraparë nga neni 6 paragrafi 1 nënpar.1.3 dhe paragrafi 2 nënpar.2.2 të Ligjit Nr. 06/L - 057, për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pasi që Prokurori i Shtetit ka vendosur për çështjen konform dispozitave ligjore.

Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit.

[REDAKTUAR]
Prokuroria Themelore në Ferizaj

- Të njoftohet:
- Këshilli Prokurorial i Kosovës.
 - Përfaqësuesi i palës ankuese [REDAKTUAR]